


**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE**  
**NJËSIA KORREKTUE : Kosovë - KORREKTUA PËR KOSOVË**  
**KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE**  
**Njësia org/Org.Jednica/Org.Uje:**  
**08 Nr./Br./No: 1008** **Dati/Datum/Date: 01 / 08 / 23**  
**Shtojcë/Dodci/Amer:** **1**  
**PREFETIVË**




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE**  
**DEPARTAMENTI I SHËRBIMIT SPROVUES - DEPARTMENT OF PAROLE AND PROBATION**  
**Njësia org/Org.Jednica/Org.Uje:**  
**07 Nr./Br./No: 82** **Dati/Datum/Date: 01 / 08 / 23**  
**Shtojcë/Dodci/Amer:**  
**PRISHTINË/A**



## Republika e Kosovës

Republika e Kosovës- Republic of Kosovo

*Qeveria- Vlada- Government*

*Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice*

## SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

DHE

## SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Rehabilitimin, Reintegrin dhe Risocializimin e Personave të Burgosur

Prishtinë

Gusht, 2023

## PËRMBAJTJA:

Hyrje .....	3
Qëllimi .....	4
Objektivat .....	4
Fushëveprimi i bashkëpunimit .....	5
Përshkrimi i bashkëpunimit .....	5
Planet e përbashkëta strategjike .....	5
Takimet e përbashkëta SHKK-SHSK .....	6
Përdorimi i instrumenteve për vlerësim të rrezikut dhe nevojave .....	7
Programet rehabilituese që aplikohen në të dy agjensionet .....	7
Përgatitja e përbashkët e të burgosurit para se të lirohet nga burgu .....	7
Bashkëpunimi me OJQ për implementim të programeve të veçanta trajtimi .....	8
Sistemi i përbashkët elektronik / informativ – Baza e të dhënave .....	8
Trajinimet e përbashkëta profesionale .....	8
Implementimi i dokumentit .....	9

## Hyrje

Detyrat e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës janë sigurimi i zbatimit të masave dhe dënimive të shqiptuara nga gjykatat kompetente në vendin tonë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) është agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë i cili në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë dhe në përshtatshmëri me legjislacionin vendor punon në korrektimin dhe risocializimin e të burgosurve duke i respektuar të drejtat e tyre fundamente pa marrë parasysh gjininë, racën, gjuhën, religionin, orientimin seksual etj. si dhe siguron një ambient të sigurt për të burgosurit në veçanti dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Vizioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës është avancimi profesional në ofrimin e shërbimeve, mbrojtja e komunitetit dhe ulja e recidivizmit.

Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) është agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë i cili merret me organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimive alternative dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu.

Misioni i Shërbimit Sprovues të Kosovës është ngritja e vetëdijes shoqërore, humanizmin e ekzekutimit të dënimive alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë në komunitet.

## **Qëllimi**

Qëllimi i këtij dokumenti është fuqizimi dhe thellimi i bashkëpunimit në mes të Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës në kuptim të rehabilitimit, reintegrimit dhe risocializimit të kryesve të veprave penale, uljen e recidivizmit dhe kthimin e tyre në komunitet si pjesë e dobishme e shoqërisë,

## **Objektivat**

Objektivat kryesore të këtij dokument-bashkëpunimi në mes të Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës janë përcaktimi i qartë i modaliteteve, procedurave dhe kompetencave në kryerjen e detyrave sa më kualitative kooperimi komfor legjislacionit në fuqi. Pikat kryesore të bashkëpunimit SHKK-SHSK janë;

- Zvogëlimi i recidivizmit;
- Bashkëpunimi profesional;
- Interesi i përbashkët
- Motivimi nga profesionistët dhe palët e interesuara dhe
- Bashkë implementimi i planeve individuale së bashku me të burgosurit.

## Fushëveprimi i bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet dy agjensioneve bazohet në përvojat më të mira profesionale dhe fokusohet në drejtim të këtyre modalitetave të cilat janë dëshmuar si efektive siç janë:

1. Planet e përbashkëta strategjike.
2. Takime të përbashkëta në nivel qendror dhe regional/lokal.
3. Përdorimi i instrumenteve afërsisht të njëjta për vlerësim të rrezikshmërisë dhe nevojave të të burgosurve/të miturve.
4. Programet rehabilituese dhe ri integruese që aplikohen në të dy institucionet.
5. Përgatitja e përbashkët e të burgosurit/të miturit para se të lirohet nga burgu.
6. Bashkëpunimi me OJQ-të për implementim të programeve të vecanta trajtimit.
7. Sistemi i përbashkët informativ-data baza.
8. Trajnimet e përbashkëta të stafit.

## PËRSHKRIMI I BASHKËPUNIMIT

### I. Planet e përbashkëta strategjike

Planet kryesore të bashkëpunimit ndërmjet dy agjencioneve bazohen në këto parime:

- Zhvillimi i besimit reciprok i cili është përbërës kyç i bashkëpunimit të efektshëm ndërmjet dy agjencioneve duke përfshirë edhe tejkalimin e pengesave në lidhje me shkëmbimin e informacioneve.
- Agjensionet të ndihmojnë njëra tjetrën duke u koordinuar në mënyrë të mirëfilltë dhe aktive për të arritur qëllime të përbashkëta në programet e rehabilitimit dhe risocializimit
- Shkëmbimi rrëth informacioneve të nevojshme për të shqyrtauar treguesit - faktorët e ndryshëm të rrezikut dhe nevojave përgjatë vuajtjes së dënimit apo lirimt të kryesve të veprave penale.
- Plani strategjik i bashkëpunimit mes dy agjencioneve të parashihet edhe me akte ligjore.
- Bashkëpunimi në mes të dy agjencioneve gjatë punës me të dhënat personale për mbrojtjen e të dhënave bazohet në legjislacionin në fuqi.

## **II. Takimet e përbashkëta SHKK-SHSK**

Takimet kanë për qëllim shkëmbimin e informatave, zhvillimin e praktikave të mira në lidhje me bashkëpunimin e ndërsjellë për lirimin e të burgosurve. Takimet kanë për qëllim edhe rishikimin e programeve, shkëmbimin e eksperiencave dhe sfidave gjatë realizimit të këtyre programeve.

Takimet me akterët relevant, organizata qeveritare dhe jo qeveritare, të realizohen sipas rasteve specifike (me rrezikshmëri të lartë dhe nevoja të veçanta).

Takimet e përbashkëta dhe të irregullta mes stafit profesional të dy agjensioneve duhet të realizohen së paku dy herë në vit.

## **III. Përdorimi i instrumenteve për vlerësim të rrezikut dhe nevojave**

Agjencionet SHKK dhe SHSK duhet të kenë instrumente të unifikuara për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për kryesit e veprave penale.

Në këtë instrument duhet të evidentohen të gjithë faktorët e rrezikut dhe nevojave për kryesit e veprave penale brenda dhe jashtë institucioneve.

Vlerësimi i faktorëve të rrezikut dhe nevojave duhet të ndodhë në mënyrë të vazhdueshme për arsy se këta faktorë janë dinamik dhe mund të ndryshojnë.

#### **IV. Programet rehabilituese që aplikohen në të dy agjensionet**

Programet e rehabilitimit luajnë një rol kyç në përpjekjet e shtetit për uljen e recidivizmit. Të gjitha programet e rehabilitimit që implementohen duhet të janë programe të akredituara dhe se varësisht nga nevojat që paraqiten në këto dy agjencione të ofrohen edhe programe të reja të rehabilitimit, risocializimit dhe ri integrimit.

#### **V. Përgatitja e përbashkët e të burgosurit para se të lirohet nga burgu**

Shërbimi Sprovues pranon Planifikimin e dënimit - Dokument që përmban të gjithë informacionin në lidhje me vlerësimin e rreziqeve për recidivizëm dhe nevojat rehabilituese të të burgosurve. Plani i dënimit ilustron gjithashtu se si i burgosuri ka përparuar me synimet e tij personale gjatë burgimit dhe çfarë veprimesh duhet të ndërmerren pas lirimit, për të zvogëluar rrezikun e përsëritjes së veprës penale.

Takimet mes zyrtarëve të dy agjensioneve dhe zyrtarëve tjerë profesionist të organizohen sidomos për rastet specifike të të dënuarve.

#### **VI. Bashkëpunimi me OJQ për implementim të programeve të veçanta trajtimi**

Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me OJQ-të, që ofrojnë shërbime të specializuara në fushat psiko-sociale, që mund të ndihmojnë në programet e rehabilitimit dhe ri integrimit përmes mekanizmave ndërinstitucional dhe lokal.

## **VI. Sistemi i përbashkët elektronik/informativ – Baza e të dhënave**

---

Për të realizuar një punë sa më efektive në rehabilitimin dhe risocializimin e kryesve të veprave penale duhet të ketë një Data bazë të përbashkët.

Kjo data bazë do të informonte agjencionet me të dhënata mbi kryesit e veprave penale.

Qasja në data bazë duhet të jetë e përbashkët për zyrtarët e të dy agjencioneve si dhe për institucionet të tjera të sigurisë, në mënyrë që të kenë njohuri në detaje për kryesit e veprave penale.

## **VII. Trajnimet e përbashkëta profesionale**

Trajnimet e stafit nga të dy agjencionet për programe rehabilituese-risocializuese dhe tema tjera të realizohen së bashku.

Dy agjencionet mund t'i shkëmbejnë trajnerët që janë të licencuar për programet dhe temat e caktuara.

### VIII. Implementimi i dokumentit

Për implementim dhe monitorim të aktiviteteve që rrjedhin prej këtij dokumenti nga drejtoritë qendrore të dy agjencioneve do të caktohet nga një anëtar i këtij grupi punues (një nga SHKK dhe një nga SHSK).

Të dy zyrtarët do të organizojnë takime dhe monitorime të përbashkëta për të siguruar zbatimin dhe suksesin e bashkëpunimit.

Zyrtarët do të bëjnë raportime së paku dy herë në vit për Drejtorët e Përgjithshëm të agjensioneve gjegjësisht Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës.

### IX. Hyrja në fuqi

Ky dokument bashkëpunimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga palët.

#### PALËT NËNSHKRUËSE



Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës



Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Sprovues i Kosovës